



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË:

MINISTRISË SË DREJTËSISË

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

DHE

ODËS SË NOTERËVE TË KOSOVËS

Prishtinë, janar 2024

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ka për qëllim koordinimin dhe bashkëpunimin e aktiviteteve duke u bazuar në kompetencat ligjore, si dhe funksionet institucionale dhe organizative të tyre në mes të Ministrisë së Drejtësisë (në tekstin në vijim Ministria), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin në vijim Këshilli Gjyqësor) dhe Odës së Noterëve të Kosovës (në tekstin në vijim Oda).

Neni 2

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Palët dakordohen që objekti i ish - Gjykatës për Kundërvajtje në Ferizaj të shfrytëzohet për arkivimin e lëndëve të Noterëve të cilët pensionohen dhe e njëjta arkiv të shërbejë për regjionet sipas nevojës së gjykatave.

2. Obligimet e Këshillit Gjyqësor:

2.1. Këshillit Gjyqësor përmes kësaj Marrëveshje obligohet që në vazhdimësi dhe pandërprerë t'i administrojë lëndët e pranuar nga noterët e pensionuar si dhe ta bëjë përzgjedhjen dhe angazhimin e nevojshëm të resurseve njerëzore që do t'iu përgjigjen kërkesave të palëve në lidhje me dokumentet noteriale të arkivuara nga gjykatat.

2.2 Obligohen gjykatat që gjatë pranim/dorëzimit të lëndëve arkivore të noterëve në gjykatë, procesverbalin e hartuar nga komisioni përkatës, ta regjistroj në regjistrin Gj.A dhe një kopje ta ruaj në gjykatë dhe një kopje t'ia dorëzoj zyrtarit kontaktues në SKGJK.

3. Obligimet e Odës:

2.2. Oda përmes kësaj Marrëveshje obligohet të kryejë të gjitha procedurat lidhur me renovimin dhe adoptimin e objektit me qëllim të vendosjes së lëndëve ku përfshihet edhe furnizimi me rafta dhe materiale të tjera të nevojshme;

2.3. Oda, tre (3) muaj më herët, duhet ta vë në dijeni Këshillin Gjyqësor për nevojën e ardhshme për nevojën e dorëzimit të lëndës arkivore të noterit i cili do të ndërprejë marrëdhënien e punës së noterit.

2.4. Oda siguron që me rastin e pensionimit të noterëve në gjykata të dërgohen vetëm lëndët noteriale që i nënshtrohen ruajtjes së përhershme të njohura si “*En minute*” dhe lëndët noteriale tjera për ruajtje sipas legjislacionit në fuqi, në formë fizike në bazë të librit të regjistrit të përgjithshëm.

Neni 3

Monitorimi

Tri institucionet nënshkruese të kësaj marrëveshje obligohen të bëjnë monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes konform autorizimeve të veta ligjore.

Neni 4

Mënyra e Bashkëpunimit

1. Palët në këtë marrëveshje do t'i bashkërendojnë aktivitetet e ndërsjella, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të tyre.
2. Palët dakordohen që për çdo çështje të komunikojnë mes veti përmes zyrtarëve kontaktues të caktuar nga palët përkatëse.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjasë për atë kohë sa nevojitet për realizimin e aktiviteteve që janë objekt i kësaj marrëveshje.

Neni 6

Ndërprerja

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, nga cilado palë nënshkruese, do të ndërpritet:
 - 1.1. në çdo kohë në rast të mos respektimit të pikave të Marrëveshjes;
 - 1.2. me paralajmërim të arsyetuar me shkrim së paku 30 ditë para datës së ndërprerjes së Marrëveshjes.

Neni 7

Ekzemplarët e marrëveshjes

Ky Memorandum i Bashkëpunimit nënshkruhet në tre (3) ekzemplarë të njëjtë, nga një ekzemplarë për secilën palë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE



Albulena HAXHIU
Ministër e Drejtësisë



Albert ZOGAJ
Kryetar i KGIK

Shpend HASKAJ
Kryetar i ONK

Nënshkruar më datë, 26/01/2024.